



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

Nr. _____ Prot.

Date, me 06/02/2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

06/02/2023

Drejtuar: ASI-2A CO Sh.p.k. me nr Nipt: K53002402C

Adresa: FIER, Lagjia Bishanak, Rruga Skenderbeu, Pallati 18, Hyrja 6

Procedura e prokurimit/lotit: "**Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar - Pune**"

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-55060-12-27-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "**Ndërtim dhe Rehabilitim KUN-je me shkarkim në rrugen Konferenca e Mukjes, Babrru**"

Fondi limit: **2 625 026 (Dy milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e njëzet e gjashtë) lekë pa tvsh.**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 28(njezete e tete) ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. ASI-2A CO SHPK

K53002402C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **2 450 400 (Dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e katërqind) leke pa tvsh**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. K.M.K SHPK

L78223801E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: **2 435 675(Dy milion e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) leke pa tvsh**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. SARK SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

K52531415H

Numri i NIPT-t

Vlera: **2 403 994** (Dy milion e katërqind e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) leke pa tvsh
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. K.M.K SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

L78223801E

Numri i NIPT-t

Operatori ekonomik ne formularin e vetdeklarimit ka deklaruar se 3 mavratorët i ka punësuar ne date 9.01.2023 duke mosplotësuar Kriteret e vecanta per kualifikim, pika 2.3.4 e cila percakton : secili punonjes i sipercituar duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per te pakten per periudhen tetor-dhjetor 2022

2. SARK SHPK

Emri i plotë i shoqërisë

K52531415H

Numri i NIPT-t

OE ne zbatim të nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar ka paraqitur dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Nga verifikimi dokumentacioni provues rezultoi:

1. Per plotësimin e kërkesës 2.3.4 te kriterëve të vecanta për kualifikim:

a. “ *Specialistet sipas profesioneve, duhet te jenë të pajisur gjithashtu edhe me kartela personale të sigurimit teknin të vlefshme të lëshuara nga organe kompetente në bazë të ligjit nr.8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit nr.13/2013, OE ka paraqitur deshmi kualifikimi e sigurimit teknik:*

- A.K., teknik ndërtimi, deshmi CN 003 15.10.2015 pa faqen e dyte që përcakton kategorine dhe datën e vlefshmërisë.
- E. K, hidraulik, deshmi CN 003 22.11.2019 pa faqen e dyte që përcakton kategorine dhe datën e vlefshmërisë.
- A. K., hidraulik, deshmi CN 003 22.11.2019 pa faqen e dyte që përcakton kategorine dhe datën e vlefshmërisë.
- Y. B. hidraulik, deshmi CN 003 15.10.2015 pa faqen e dyte që përcakton kategorine dhe datën e vlefshmërisë
- P. S. saldator deshmi CN 003 22.11.2019 pa faqen e dyte që përcakton kategorine dhe datën e vlefshmërisë
- T. XH, manovrator, CN 003 22.11.2019 pa faqen e dyte që përcakton kategorine dhe datën e vlefshmërisë
- B. M., manovrator nuk ka deshmi kualifikimi të sigurimit teknik.
- D. S, manovrator nuk ka deshmi kualifikimi të sigurimit teknik

b. “*secili punonjës I sipercituar , duhet të figurojë në listëpagesën e shoërisë për të paktën periudhën tetor – dhjetor 2022.*

Për plotësimin e këtij kriteri OE ka paraqitur listëpagesat për muajt tetor, nëntor, dhjetor 2022 nga verifikimi I të cilave rezulton se : ing. I ndërtimi paguhet 15 ditë në muaj, inxhinieri topograf 3 ditë në muaj të cilat janë drejtues teknik të shoqërisë, ndërsa pjesa tjetër e stafit paguhet me 1 ose 2 ditë në muaj. Kjo ul besueshmërinë e AK në realizimin e kontratës nga ky OE.

Konkluzion : OE nuk plotëson Pikën 2.3.4 te kriterëve të vecanta për kualifikim

2. Per plotësimin e kërkesës 2.3.5 te kriterëve të vecanta për kualifikim “OE duhet të ketë në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si më poshtë (sipas fomularit të vetëdeklarimit)

Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur rezulton :

- Për makinerinë e kërkuar Ekskavator (cop1) dhe Kamioncinë transporti 5 ton (cop 1) : OE ka paraqitur Kontratë Shërbimi, nr. __ prot, datë 04.05.2022 Me palë Porositëse shoqëria “Sark” shpk dhe Ofrues shërbimi Person fizik L.M në këtë kontratë neni V {Cmimi I ofruar” përcaktohet se ofruesi shërbimit do të paguhet mbi bazën e punës së kryer dhe vendoset sipas shërbimit të ofruar . vlera totale për ofrimin e shërbimit sipas kësaj kontrate bëhet sipas situacioneve mujore që do dorëzohen tek porositësi së bashku me faturën tatimore.

Nga sa më lartë kjo kontratë nuk është një kontratë qiraje por një kontratë shërbimi (sipërmarrje). OE ekonomik nuk është paraqitur si bashkim shoqerish sipas përcaktimeve në nenin 88 të VKM 285, dhe në shtojcën e vetedeklarimit ka cilësuar se nuk ka nënkontraktor dhe nuk është ,mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera. Në këto kushte ky operator ekonomik nuk I ka në dispozicion këto makineri.

- Për makinerinë e kërkuar Kamion me vinc. OE ka paraqitur Kontratë shërbimi (mjete) nr,38 prot, datë 01.12.2022. me ofrues shërbimi K. R dhe porositës Sark sh.p.k. kjo kontratë në përmbajtje është një kontratë qeraje mjetesh pa afat. Nga verifikimi I dokumentacionit bashkëlidhur kontratës rezulton se mjete kamion me Targa DL3165A, është në pronësi të shtetasit F.R dhe jo kontraktuesit K.R gje e cila e bën të pavlefshme këtë kontratë

Konkluzion : OE nuk plotëson Pikën 2.3.5 te kriterëve të vecanta për kualifikim

SHËNIM: OE ka paraqitur një dokumentacion jo serioz ku të gjitha dokumentat justifikues të mjeteve (certifikat pronësie, leje qarkullimi, certifikat kontrolli teknik, siguracion jane fotokopje të errëta të palexueshme.

Për sa më lartë OE skualifikohet për mosplotësim të kërkesave për kualifikim të vendosura nga AK

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **ASI-2A CO SHPK me nr Nipt: K53002402C**, me Adresë: FIER, Lagjia Bishanak, Rruga Skenderbeu, Pallati 18, Hyrja 6 se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **2 450 400 (Dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë e katërqind) leke pa tvsh** totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjetës Kanalizime Kamëz sh.a, adresa: Rr. “Paqësori”, Frutikulturë, Kamëz, Tel/Fax 042222999 sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, (**Referuar vleresimit te mesiperme ne kete procedure nuk kemi ofertues tjeter te vleshem**) oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej _____ siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Eris MARTINI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM